



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FIER

Nr. 4832/2 Prot.

Fier, më 05 . 06 . 2023

Lënda: Njoftim për zhvillimin e Mbledhjes së Parë të Konstituimit të Këshillit të Bashkisë Fier

Prefektit të Qarkut Fier

Për Dijeni: Ministrisë së Brendshme Tiranë

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit të Republikës nr.13864 datë 24.10.2022 **“Për përcaktimin e datës së Zgjedhjeve për organet e vetëqeverisjes vendore”**, më datën 14 Maj 2023 u zhvilluan zgjedhjet për organet e vetëqeverisjes vendore.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, me **Vendimin nr.641 datë 26.05.2023**, **“PËR SHPËRNDARJEN E MANDATEVE NDËRMIJET SUBJEKTEVE ZGJEDHORE PËR KËSHILLIN E BASHKISË, FIER, PËR ZGJEDHJET E ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023”**, ka vendosur shpërndarjen e mandateve për subjektet zgjedhore në zonën zgjedhore Bashkia Fier, dhe ju ka shpallur kandidat fitues nga listat shumëemërore të subjekteve zgjedhore, të miratuara nga KQZ, për Këshillin e Bashkisë Fier.

Bazuar në nenin 48 pika 1, të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 **“Për vetëqeverisjen vendore”** i ndryshuar, Këshilli Bashkiak zhvillon mbledhjen e tij të parë jo më vonë se 20 ditë nga data e shpalljes së rezultatit nga organi kompetent, i përcaktuar në Kodin Zgjedhor.

Ju Njoftojmë se ditën e Hënë, në datën 12.06.2023, në orën 10:30, në ambjentet e sallës së mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Fier, do të zhvillohet Mbledhja e Parë e Konstituimit të Këshillit të Bashkisë Fier, me këtë Rend Dite:

1. Hapja e mbledhjes nga Sekretari i Këshillit të Bashkisë Fier
2. Zgjedhja e Komisionit të Verifikimit të Mandateve,
3. Miratimi i Raportit të Komisionit të Verifikimit të Mandateve.
4. Kryerja e Betimit dhe nënshkrimi i Aktit të Betimit nga Këshilltarët prezentë.
5. Zgjedhja e Komisionit të Votimit.
6. Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit të Bashkisë Fier
7. Zgjedhja e Zëvendëskryetarëve të Këshillit të Bashkisë Fier
8. Shpallja e Vlefshmërisë së Mandatit të Kryetarit të Bashkisë Fier
9. Kryerja e Betimit dhe nënshkrimi i Aktit të Betimit nga Kryetari i Bashkisë Fier.
10. Zgjedhja e anëtarëve që do të përfaqësojnë Këshillin e Bashkisë Fier, në Këshillin e Qarkut Fier, dhe pajisja me mandatin e përfaqësimit

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin

SEKRETARI I KËSHILLIT TË BASHKISË FIER

Arnando ÇUPA

